

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo

Nr. 7743 Data. 22.09.2025
Mitrovicë Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 dhe 10, paragrafi 2 dhe nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., dhe në bazë të nenit 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., Trepça Sh.A me datë 22.09.2025 publikon këtë:

K O N K U R S për personat me aftësi të kufizuara

Pranim

Aplikimi është i hapur vetëm për personat me aftësi të kufiuara.

Titulli i pozitës së punës:	METALOPUNUES
Koeficienti/Paga	510€ bruto
Nr. i kërkuar	2
Kohëzgjatja e emërimit	Në periudhë të pacaktuar (Puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit	22/09/2025
Afati për aplikim	23/09/2025-07/10/2025
Institucioni	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore	Fabrika e Paimëve të Procesit
Vendi i punës	FPP (Mitrovicë)

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Cakton llojin , sasinë (numrin) e veglave punuese , menyrën e shtrëngimit .
- Njohja e përdorimit e të gjitha mjeteve për gdhendje , si dhe aftësi për mprehje dhe përdorim praktik.
- Përpunimi i viztimeve punuese dhe skicave.
- Të përpunoj të gjitha mënyrat e komplikuar të gdhendjes .
- Punimi i bulonave me disa fillesa me thikë të profiluar dhe gjysëm profiluar.
- Punimi me torno i të gjitha veglave – rotacione.
- Përdorimi i të gjithë elementeve deri në kualitetin IT5 .
- Përpunimi i të gjithë materialeve.
- Vetë përgatitja e të gjithë veglave shtrënguese për operacione të komplikuar.
- Vetë punimi i veglave speciale.
- Përpunimi i sipërfaqeve konik dhe sferik
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së përgjegjësit në kuadër të profesionit.
- Obligohet t'i përmbahet rregullave të mbrojtjes në punë.
- Për punën e tij i përgjigjet kryepunëtorit.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jeni person me aftësi të kufizuara (duhet të dëshmohet me dokumentacion përkatës të lëshuar nga organet kompetente);
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njëërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën; kategorinë, klasën apo grupin përkatës.

3. Kriteret e veçanta

- Çertifikatë e Aftësimit Profesional – drejtimi Metalopunues.
- Të ketë përvojë pune ose punë praktike në profesionin e tij së paku 3 muaj.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshmi për përvojën e punës apo punës praktike, ose dokumentacion të ngjashëm që dëshmon përvojën apo përgatitjen tuaj në këtë fushë.
- Të posedoni dëshmi nga organi kompetent se jeni person me aftësi të kufizuara;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Çertifikatën e noterizuar mbi kualifikimin profesional.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes e-mail dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”


7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesit do të shpallen përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” dhe do të njoftohen edhe në mënyrë elektronike. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A.
Kryeshefi Ekzekutiv

Faton Ahmeti